



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 07.09.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 07.09.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Eing-Com" për aktivitetin: "Furnizimi me shporta xhepi dhe ulëse" dhe me numër të prokurimit: **616-18-5173-121** nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekono**"Eing Com"** e datës 07.09.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me shporta xhepi dhe ulëse" me Nr.616 18 5173 121,Nr. Brendshëm 616 18 083 121 211 kundër *Njoftimit për anulim të aktivitetit*, të datës 03.09.2018, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Vërtetohet *Njoftimi për anulim të aktivitetit* i publikuar me datë: 03.09.2018;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj respektimin e Vendimit për anulim të aktivitetit*.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **"Eing Com"** me datë 03.09.2018 ka parashtruar kërkesën-ankesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me shporta xhepi dhe ulëse" me Nr.616 18 5173 121 Nr. Brendshëm 616 18 083 121".
Autoriteti Kontraktues, me datë 03.09.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:
Pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë plotësisht të pa bazuara pasi që janë të pa bazuara në dispozitat ligjore pasi që Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari përgjegjës i Prokurimit nuk ka bërë krahasim të ofertave të ndryshme, por ka krahasuar ofertat në raport

me poentimin e paraqitur në përshkrimin e çmimit, respektivisht ka krahasuar devijimet e paraqitura në secilën ofertë nga poentimi i parashikuar dhe në bazë të të njejtës ka konstatuar se çmimet e manipuluar janë tepër të disfavorshme për Autoritetin dhe në shpërputhje të plotë me poentimin e parashikuar. Pra ky krahasim nuk ka të bëjë me nenin 28.15 të RRUOPP, por është plotësisht i bazuar në dispozitat ligjore.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në sqarimet e paraqitura më lartë dhe në sqarimet detale nga Vendimi për anulim ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit